



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

1107/20

25.01.2021

PRISHTINË - PRISTINA

PSH.nr.1107/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenkovic - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.N.SH (Korben) “Roza Komani B.I”-Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE N.N.SH “Marash-Shped” SH.P.K-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrethimi dhe rregullimi i oborreve në shkolla” me nr. të prokurimit 632-20-6633-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “KK-Gjakovë”, më datën: 22.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.N.SH (Korben) “Roza Komani B.I”-Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrethimi dhe rregullimi i oborreve në shkolla” me nr. të prokurimit: 632-20-6633-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Gjakovë”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull “Rrethimi dhe rregullimi i oborreve në shkolla” me nr. të prokurimit: 632-20-6633-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Gjakovë”, dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.N.SH.(Korben) “Roza Komani B.I”-Gjakovë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues N.N.SH (Korben) “Roza Komani B.I”-Gjakovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 17.12.2020 me nr. 1107/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrethimi dhe rregullimi i oborreve në shkolla” me nr. të prokurimit: 632-20-6633-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 69, 60 parag.1, 69 parag.6.4 & 6.5 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 41 parag. 1 i RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt. 05.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 1

Pretendimi i parë ankimore sipas ankesës nr. 1107/20 është se OE I rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes për punë të ngjashme, me arsyetim se në dy kontrata OE ka qenë anëtar e jo lider I grupit, dhe se kontratat që I ka me operator privat nuk duhet të pranohen sepse OE nuk ka ofruar transaksione bankare. Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk mund të refuzohen referencat/kontratrat me

arsyetim se OE nuk ka qenë lider I grupi, e po ashtu nuk mund të refuzohen referenca për mungesë të transaksioneve derisa transaksionet nuk kanë qenë kërkesë decisive në dosje të tenderit Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimore të OE ankues janë të pabazuara.

Përgjigje në pretendimin nr. 2

Pretendimi i dytë ankimore është se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes për kapacitet teknik/profesional më konkretisht:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 10 (dhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a.) një inxhinier I diplomuar apo master i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv me 5 vjet provoj pune b.) një inxhinier I diplomuar apo master i arkitekturës me 5 vjet provoj pune.

Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore, CV-a, diploma, kontrata e punës me ofertuesin (origjinal, në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë)

Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, kemi gjetur se I njëjti në ofertë si në listën e propozuar nga kompania , e po ashtu edhe në listë të punëtorëve të ATK-së I ka gjithsej 9 punëtor duke përfshirë edhe inxhinierët. Bazuar në këtë që u cek më lart vlerësojmë se OE I rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes 9.1&9.2 dhe pretendimi ankimore në këtë pikë është I bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet pjesërisht e bazuar, ndërsa të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 05.01.2021 me raportin e ekspertizës.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 22.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës,

ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

Pretendimi i OE ankues ka të bëjë me tenderin e OE të rekomanduar për kontratë, ku në ankesë ceket se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes për punë të ngjashme, me arsyetim se në dy kontrata, OE ka qenë anëtar e jo lider i grupit, dhe se kontratat që i ka me operator privat nuk duhet të pranohen sepse OE nuk ka ofruar transaksione bankare. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se nuk mund të refuzohen referencat/kontratat me arsyetim se OE nuk ka qenë lider i grupit, e po ashtu nuk mund të refuzohen referenca për mungesë të transaksioneve derisa transaksionet nuk kanë qenë kërkesë decidive në dosje të tenderit. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi tjetër ankimor i OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes për kapacitet teknik/profesional më konkretisht:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 10 (dhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a.) një inxhinier I diplomuar apo master i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv me 5 vjet provoj pune b.) një inxhinier I diplomuar apo master i arkitekturës me 5 vjet provoj pune.

Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore, CV-a, diploma, kontrata e punës me ofertuesin (original, në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë)

Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se i njëjti në ofertë, si në listën e propozuar nga kompania, e po ashtu edhe në listë të punëtorëve të ATK-së i ka gjithsej 9 punëtor duke përfshirë edhe inxhinierët. Bazuar në këtë që u cek më lart, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes 9.1&9.2 dhe pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë tenderin i cili nuk plotëson kërkesën e AK-së në lidhje me numrin e punëtorëve, ku është kërkuar së paku 10 punëtor, ndërsa OE i rekomanduar ka

vetëm 9 punëtor duke përfshirë edhe inxhinierët. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të ketë parasysh kërkesat e dosjes së tenderit dhe të veprave në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Gjakovë";
- 1x1 OE N.N.SH(Korben)"Roza Komani B.I"-Gjakovë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.